

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË,  
DHE INOVACIONIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA ARSIMIT

Nr. 2384/3 Prot. datë 30.01.2026

Nr. 933 Prot. datë 02.02.2026

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 81, datë 30.01.2026

PËR  
NGRITJEN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT SEKTORIAL TË  
BUJQËSISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 10 247, datë 4.3.2010, "Për kornizën shqiptare të kualifikimeve", të ndryshuar; të vendimit nr. 426, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e organizimit, të funksionimit, si dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të komiteteve sektoriale dhe mënyrën e shpërblimit të tyre", ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional dhe ministri përgjegjës për arsimin,

URDHËROJNË:

1. Ngritjen e Komitetit Sektorial të Bujqësisë.
2. Komiteti Sektorial i Bujqësisë organizohet në formën e grupit teknik dhe ka në përbërje 10 (dhjetë) anëtarë si më poshtë:
  - a) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin;
  - b) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional;
  - c) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për sektorin e Bujqësisë;
  - ç) një përfaqësues nga shoqatat e punëdhënësve të sektorit të Bujqësisë, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës;
  - d) një përfaqësues nga shoqatat e punëmarrësve që mbulojnë sektorin Bujqësisë, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës;
  - dh) një përfaqësues nga institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional (AFP) të sektorit Bujqësisë, me numrin më të madh të nxënësve/kursantëve në sektorin përkatës;
  - e) një përfaqësues të biznesit me praktika të pasura në zhvillimin e burimeve njerëzore në sektorin Bujqësisë;

ë) tre ekspertë të pavarur, me përvojë jo më pak se 5 (pesë) vjet në zhvillimin dhe zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).

3. Kryetari zgjidhet në mbledhjen e parë të komitetit dhe, si rregull, duhet të jetë anëtar i me më shumë eksperiencë në çështjet Bujqësisë dhe në zhvillimin e zbatimit të KSHK-së.

4. Ngarkohet Ministria Ekonomisë, dhe Inovacionit për përzgjedhjen e përfaqësuesve respektivë, sipas germave “a”, “b”, “c”, dhe dh,” të pikës 2 të këtij urdhri, në bazë të kriterëve të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 426, datë 26.6.2019, dhe përcjelljen e tyre Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), jo më vonë se 3 (tre) muaj nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

5. Ngarkohet AKAFPK-ja për përzgjedhjen e anëtarëve sipas shkronjave “ç”, “d”, “e” dhe “ë”, të pikës 2 të këtij urdhri, si dhe titullari i saj për ngritjen e sekretariatit teknik, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja e tij në fuqi.

6. Ngarkohen ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, ministria përgjegjëse për arsimin, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe Komiteti Sektorial i Bujqësisë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËRI EKONOMISË DHE  
INOVACIONIT**

**Delina Ibrahimaj**



**MINISTËRI I ARSIMIT**

**Mirela Kambaro**

